Kronikë

Vlorë/ Policia arreston 27- vjeçarin, qëlloi me kallashnikovë në ajër

Një 27-vjeçar është vënë në pranga sot nga policia në Vlorë, pasi u kap në flagrancë duke qëlluar në ajër me armë zjarri

Redaksia
15 Qershor, 09:19 | **Përditesimi: 15 Qershor, 09:37**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Një 27-vjeçar është vënë në pranga sot nga policia në Vlorë, pasi u kap në flagrancë duke qëlluar në ajër me armë zjarri.

Njoftimi i Policisë:

> *Në zbatim të masave të megaoperacionit "Sundimi i ligjit", u finalizua operacioni i koduar "Strike 14 ", për goditjen e një rasti në fushën e mbajtjes pa leje të armëve.*

LEXO EDHE:
Vlorë/ Aksident te rrethrrotullimi që të çon në Nartë, makina përplaset me bordurat anësore, 2 të plagosur (FOTO)

Lëvizte me armë zjarri, vihet në pranga 27-vjeçari. Ky shtetas u kap në flagrancë pasi kishte qëlluar në ajër, me armën e zjarrit.

Sekuestrohen arma e zjarrit kallashnikov me krehër me municion luftarak dhe një mjet prerës biçak, që iu gjetën 27-vjeçarit, gjatë kontrollit fizik.

Në zbatim të masave të megaoperacionit "Sundimi i ligjit", Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Vlorë, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative se një shtetas lëvizte i armatosur, finalizoi operacionin e koduar "Strike 14 ", për kapjen e tij.

Si rezultat, u arrestua shtetasi Amarildo Sejdini , 27 vjeç, banues në Vlorë. Ky shtetas është kapur në flagrancë nga shërbimet e Policisë, pasi kshte qëlluar me armë zjarri në vendin e quajtur "Kuzum Baba", në lagjen "Partizani", duke rrezikuar banorët e zonës.

Gjatë kontrollit fizik, shtetasit Amarildo Sejdini. i është gjetur 1 armë zjarri kallashnikov me krehër me municion luftarak dhe 1 mjet prerës biçak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

S.B/E.H/Shqiptarja.com

TAG: kallashnikov | policia e vlorës | Vlore

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Shqipëria luan ndaj Italisë sfidën e parë në Euro 2024, kush fiton?

Italia | Shqipëria | Barazim

Lajme të tjera

Himarë, delfinët shoqërojnë turistët gjatë lundrimit (VIDEO)
14 Qershor, 18:24

Sezoni i ri nis me 'halle' të vjetra! Në Vlorë, privatët ngulin çadrat në plazhin publik! Kullat janë bosh, mungojnë vrojtuesit!
Armand Xhelili
14 Qershor, 16:16

Përndoqi dhe përplasi me makinë të dashurën kolege, arrestohet polici i Himarës (EMRI)
13 Qershor, 20:50

Vlorë/ Pas disa orësh shpëtohet çifti belg që kishte ngecur në kanionet e Gjipesë (FOTO+VIDEO)
13 Qershor, 19:28

Vlorë/ Parakaloi me shpejtësi autobusin, mjeti humb kontrollin dhe përplaset me qepenin e biznesit! Lëndohet shoferi
13 Qershor, 11:55

Shëtiste turistët pa licencë, bllokohet jahti në Karaburun, gjobitet me 100 mijë lekë pronari
13 Qershor, 08:31

Vlorë/ Nigeriani tenton të dalë nga Shqipëria me dokumente italiane false, ndalohet në port
12 Qershor, 16:11

Aksident në Bypassin e Vlorës, makina përplaset me pjesën shkëmbore në anë të rrugës! Vdes shoferi dhe plagoset pasagjeri (FOTO+VIDEO)
12 Qershor, 16:06

Vlorë/ Banesa e braktisur u përfshi nga flakët, humb jetën 70-vjeçari endacak
12 Qershor, 08:52

Digjet një banesë në Vlorë, shënohet një viktimë
11 Qershor, 21:56

Vlorë/ Tentuan të kalojnë kontrabandë verë dhe paketa me cigare, vihen nën hetim 3 persona
11 Qershor, 15:58

Vrau me grusht biznesmenin në Vlorë, Apeli ul me 6 muaj dënimin për djalin e anëtares së KLP-së, do të vuajë 18 muaj burgim
10 Qershor, 17:16

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje